



Pranuar / Dorezuar Punijena/Prudato Received/Delivered	20.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHOLA	6616/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1144/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1144/2023 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1144/2023 e datës 05.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

Nëpunësi civil [redacted] i punësuar në pozitën e punës "Udhëheqës i sektorit për pronësi shpronësim dhe këmbime" në kuadër të Departamentit Drejtoria e Pronës në Komunën e Prishtinës, sipas Akt Emërimit me numër 01 nr.112-1040 të datës 16.04.2019, ankuesi me datë 05.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5956/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti bëhet kompensimi për funksione shtesë në shumën prej 30% të pagës bazë të zyrtarit kryesor administrativ si dhe ti bëhet pagesa e shumës së mbetur pa paguar për muajt e kaluar kur është hy në fuqi Rregullorja (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 10.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5956/2023 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga Xh.Z. për ankesa.kpmschck@rksgov.net i datës 05.09.2023; E-mail nga ankesa.kpmschck@rksgov.net për Xh.Z. i datës 05.09.2023; Vendim për formimin e komisionit të ankesave i Komunës së Prishtinës me numër 14-020/04-37824/22 i datës 22.02.2022; Kërkesë për kompensim për funksionet shtesë me numër protokolli 14-120/06-49957/23 i datës 07.03.2023; Letërnjoftim i Xh.Z.; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 22.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 10.10.2023; Akt Emërim i Xh.Z. me numër 01 nr.112-1040 i datës 16.04.2019; Vendim me numër 14-112/01-85920/19 i datës 15.04.2019; Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e komisionit të ankesave për nëpunësit civil me numër 14-020/04-260697/22 i datës 02.12.2022; Kartela financiare viti 2023; E-mail nga M.Ll. për C.Z. i datës 04.10.2023; Pliko e datës 06.10.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit me numër 01 nr.112-1040 të datës 16.04.2019, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Udhëheqës i sektorit për pronësi shpronësim dhe këmbime" në kuadër të Departamentit Drejtoria e Pronës në Komunën e Prishtinës. Kolegji i Këshillit po ashtu ka konstatuar se ankuesi me vendim të Kryetarit të Komunës së Prishtinës me datë 22.02.2023 me numër protokolli 14-020/04-37824/22 është caktuar Kryetar i komisionit të ankesave me mandat tre (3) vjeçar në Komunën e Prishtinës. Ndërsa ankuesi me datë 07.03.2023 me numër protokolli 14-120/06-49957/23 ka bërë kërkesë kompensim për funksionet shtesë tek Kryetari i Komunës së Prishtinës.

Ankuesi, me datë 05.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti bëhet kompensimi për funksione shtesë në shumën prej 30% të pagës bazë të zyrtarit kryesor administrativ si dhe ti bëhet pagesa e shumës së mbetur pa paguar për muajt e kaluar kur është hy në fuqi Rregullorja (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", si rrjedhojë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar lidhur me kompensimin për



funksiione shtesë në shumën prej 30% të pagës bazë të zyrtarit kryesor administrativ si dhe ti bëhet pagesa e shumës së mbetur pa paguar për muajt e kaluar kur është hy në fuqi Rregullorja (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë.

Duke marrë parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", si rrjedhojë meqenëse ankuesi me datë 07.03.2023 me numër protokolli 14-120/06-49957/23 ka bërë kërkesë kompensim për funksionet shtesë tek Kryetari i Komunës së Prishtinës, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 06.09.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1144/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.